



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUHAJ  
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1  
Tirane  
TEL: 0692097547

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (AKSIONE)

Nr. repertori: 4474

Nr. koleksioni: 1748

Tirane më 28/09/2023

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

❖ Ky material përbëhet nga 3 fletë



A2023053540185950351



A2023053540185950351

## KONTRATË DHURIMI KUOTE KAPITALI

(TË-SHOQËRISË "ALBANIAN BEES AND HONEY" SH.P.K)

Sot, më datë 28/08 /2023 (dymije e njezet e tre), perpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqiten personalisht:

**PALA DHURUESE: Gjergj Legisi**, atësia Ndre, amësia Vojsava, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Ndreko Rino; Nd. Pall 22; H. Shk 1; Ap. Apt 146; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 03/10/1986, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034589333 dhe nr. personal I61003040N.

(këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si "**Dhurues**").

**PRANUES I DHURIMIT: Vojsava Legisi**, atësia Feti, amësia Xhevo, shtetase Shqiptare, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Bulevardi Zogu I Parë; Nd. 10; H. 2; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 06/04/1961, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034489651 dhe nr. personal G15406164F.

(këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si "**Pranues Dhurimi**").

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 761 e vijues i tij; si edhe ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 62, pika 1, gërma "l", si dhe nenet 99, 100, 101; si dhe Udhëzimit nr. 232, datë 14.1.2016 "Mbi ndryshimin e Pronësisë së mjeteve rrugore" e vijues bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Dhurimit Pasuri e Luajtshme – kuota, sipas kushteve dhe kriterëve ligjore të mëposhtme:

### KUSHTE PARAPRAKE:

- Pala shitese ne baze te Ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, eshte ortak me 1 pjese e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise "Albanian Bees and Honey" SHPK, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 23/10/2019, me Nipt L98423301F.
- Kapitali i shoqerise eshte 324.000,00 Para dhe ne Natyre 33.687.900,00, dhe pala shitese eshte zoterues i nje pjese e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise.
- Sipas rezultatit te kerkimit te leshuar nga Regjistri i Barreve Siguruese, per shitesin, nuk ka asnje barre te regjistruar .
- Ortaku ka vendosur, transferimin nepermjet dhurimit te pjeses qe ai zoterone cila perben 100% te kapitalit te shoqerise "Albanian Bees and Honey" SHPK, tek pala pranuese te dhurimit.

### Neni 1- Baza Ligjore

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;  
Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";



### Neni 2 - Objekti i kontrates

Pala dhuruese, transferon ne ane te kesaj kontrate, me vullnet te lire e te plote ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Statutit te Shoqerise, e pjeses qe ajo zoteron, me vlere te pergjithshme 324.000,00 ne para dhe 33.687.900,00 ne natyre, qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise "Albanian Bees and Honey" SHPK.

### NENI 3 - MENYRA KALIMIT TE PRONESISE

Pala dhuruese do ti kaloje pales pranuese te dhurimit pronesine mbi kuotat pa kundershperblim. **Kete dhurim pala dhuruese e ben ne favor te pales pranuese te dhurimit per shkak te marredhenieve familjare qe palet kane ndermjet njeri -tjetrit (prind-femije). Palet deklarroje se ky eshte dhurim I pare qe palet bejne ndermjet tyre.**

### Neni 4 - Garancite

Pala Dhuruese deklarone dhe garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotes qe transferohet nepermjet kesaj kontrate dhe se ajo eshte e lire nga çdo barre apo pretendim tjetër ligjor.

### Neni 5- Heqje dore nga te drejtat

Pala dhuruese deklarone nen pergjegjesine personale, se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne ne cilesine e pales dhuruese ne lidhje me pjesen qe transferone, pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

Pala dhuruese deklarone se deri ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate, shoqeria nuk ka asnje detyrim te prapambetur.

Pala dhuruese merr persiper, qe mbas nenshkrimit te kesaj kontrate, nese dalin probleme me klientet apo probleme te cilat kane lidhur perpara nenshkrimit te kesaj kontrate do te jete i gatshem te ndihmoje ne zgjidhjen e ketyre problemeve.

Te gjitha detyrimet e shoqerise " Albanian Bees and Honey" shpk dhe pretendimet para dates se nenshkrimit te kontrates do te mbaje pergjegjesi ortaku i vetem, pranuesi i dhurimit.

### Neni 6- Efekte ligjore

Pas realizimit te ketij transferimi, me nenshkrimin e kesaj kontrate :

- Pranuesi I dhurimit behet ortak i vetem i shoqerise "Albanian Bees and Hone" SHPK.
- Gjergj Legisi largohet si ortak i shoqerise shoqerise "Albanian Bees and Honey" SHPK.
- Administrator i shoqerise "Albanian Bees and Honey" shpk do te jete Vojsava Legisi, e cili do te emerohet per nje afat te pacaktuar.
- Me nenshkrimin e kesaj kontrate pala dhuruese humbet çdo te drejte pronesie mbi pjesen e kapitalit qe transferone, te drejta te cilat jane transferuar tek pala blerese.
- Regjistrimi i kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit, do te behet menjehere pas nenshkrimit te kesaj kontrate.



A2023053540185950351

Neni 7-Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Çdo lloj mosmarreveshje që mund të lidhet me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirekuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e ketyre mosmarreveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata e Dhurimit të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALA DHURUESE:**

Gjergj Legisi

*Gjergj Legisi* 

**PALA PRANUESE E DHURIMIT :**

Vojsava Legisi

*Vojsava Legisi* 

**NOTERE**

**MIMOZA SADUSHAJ**

